



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.978/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtar Gent Bekeri, në çështjen përmbaremore të kreditorit KS “Kosova e Re”, me nr. të biznesit 70034247, adresa Lagjja “Kalabria”nr.5 Blloku B1, me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.T.P AUTO LAMI, me numër të biznesit: 70094126, adresa rr. Lipjan-Prishtinë, me seli në Lipjan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Behar Sejda avokat nga Ferizaj, për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.272/21 të datës 22.04.2021, të Përmbaremit Privat Sheremet Livoreka, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 17.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit N.T.P AUTO LAMI, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.272/21 të datës 22.04.2021, të Përmbaremit Privat Sheremet Livoreka, nga Ferizaji.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.272/21 të datës 22.04.2021, i Përmbaremit Privat Sheremet Livoreka, nga Ferizaji.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Kosova e Re”, me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbaremore P.nr.272/21 të datës 22.04.2021, me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr.225794 e datës 08.06.2018, nga mjetet financiare të debitorit N.T.P AUTO LAMI, nga cilado llogari rrjedhëse e saj në cilëndo bankë afariste në Kosovë, ku e përmbaremi i ka mjetet e saj financiare, në emër të borxhit t’i bëhet pagesa propozuesit të përmbaremit-kreditorit KS “Kosova e Re”, në shumën prej 1,411.28 Euro.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbaremit brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim me arsyetimin se urdhri përmbaremore është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Tutje ka theksuar se dokumenti në bazë të cilit është marrë urdhri përmbaremi nuk i ka

tiparet e përmbarueshmërisë, për arsye se dokumenti në bazë të cilit është marrë urdhri përmbarues nuk ka efekt juridik ngase kërkesa e kreditorit është parashkruar, dhe si e tillë nuk mund të përmbarohet. Tutje ka shtuar se përmbaruesi privat kur e ka lejuar urdhrin, nuk e ka elaboruar këtë dokument duke qenë se në atë dokument përmbarues nuk definohet qartë se për çfarë periudhe kohore kërkohet ky borxh, cili ishte shërbimi ndaj debitorit që do të ishte satisfaksion apo në kundërvlerë, po ashtu nuk është definuar periudhë kohore kur palët do të përmbushnin detyrimet ndaj njëra tjetrës, konkretisht kreditori nuk ka paraqitur asnjë dëshmi se ka përmbushur detyrimet e saja ndaj debitorit. Debitori i ka propozuar gjykatës të aprovohet prapësimi, dhe të hedhet poshtë si i palejuar urdhri përmbarimor i Përmbaruesit Privat.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim me të cilën ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pa bazuara, me arsyetimin se fatura është pranuar dhe është nënshkruar nga ana e debitorit, dhe asnjëherë nuk është mohuar borxhi i papaguar ndaj kreditorit. Tutje ka shtuar se fatura e dërguar në përmbarim i përmban të gjitha elementet për t'u përmbaruar, dhe se sipas tij debitori është thirrur gabimisht në parashkrim sepse sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve fatura nuk është parashkruar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pa bazuar, andaj, të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Debitori nuk ka ofruar asnjë provë me shkrim siç parashihet me nenin 69 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilit: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, me të cilën do të mund të argumentonte pretendimet e cekura në prapësim apo se ekziston ndonjëri nga shkaqet e përcaktuara në nenin 71 të LPP-së, në të cilat bazohet prapësimi i palës.

Përkundër faktit se debitori nuk ka bashkangjitur prova, Gjykata i ka shqyrtuar pretendimet e debitorit në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë arsye ligjore për anulimin e urdhrin për përmbarim.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”* Kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e Përmbartuesit Privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht Faturës nr.225794 e datës 08.06.2018, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, është përshkruar shërbimi i cili ka qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në rastin konkret rezulton se fatura është dorëzuar në origjinale nga ana e kreditorit dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila e cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi i debitorit si dhe fakti që faturat nuk është kontestuar asnjëherë.

Duke vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit, gjykata pas vlerësimit të faturës nr.225794 e datës 08.06.2018, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 355 paragrafi 1, dhe paragrafi 2 të LMD-së (Ligji Nr.04/L-077), ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit nuk është parashkruar.

Me dispozitën e nenit 355 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të të njëjtit nen përcaktohet se: “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*.

Andaj, nisur nga kjo, në rastin konkret gjykata gjen se kërkesa e kreditorit nuk është përfshirë në parashkrim, ngase nuk ka kaluar afati tre (3) vjeçar nga momenti i lëshimit të faturës me datën 08.06.2018, e deri në paraqitjen e propozimit për përmbarim pranë organit përmbarues me datën 22.04.2021.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.978/22, datë 17.10.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.